

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EPA SOLAR INVESTMENTS” SHPK

NENI 1
THEMELIMI

- 1.1** Shoqeria me pergjegjesi te kufizuara “EPA Solar Investments” Shpk. (ne vijim referuar si “**Shoqeria**”)themelohet sipas Ligjit shqiptar nr.9901, date 14.4.2008 “*Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*”, i ndryshuar dhe fiton personalitetin juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit ne Tirane, Shqiperi.

NENI 2
SELIA

- 2.1** Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga “Muhamet Gjolllesha” , ZK 8270, nr.pasurie 6/487+1-19, Njesia Bashkiake Nr.5., Tirane, Shqiperi.
- 2.2** Shoqeria mund te hape dhe te mbaje dege, zyra dhe/ose te ushtroje aktivitet tregtar ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Statutin e shoqerise.

NENI 3
OBJEKTI I SHOQERISE

- 3.1** Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte perfshirja ne cdo transaksion te ligjshem dhe/ose angazhimi ne aktivitete te ligjshme per qellime te cilave mund te themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjeve te Shqiperise, me ndryshimet e tyre te here pas hershme.

Aktiviteti i Shoqerise perfshin pa kufizuar sa me poshte:

1. organizimi, blerja e tokes, studimi, projektimi, ndertimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve telidhura me to, per prodhimin e energjise nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirembajtja dhe mbeshtetja teknike;
2. studimi, pergjithesisht te gjitha sherbimet mbeshtetese ne fushen e industrise dhe energjise;
3. pjesemarrja ne tendera te te gjitha llojeve ne fushen e industrise dhe energjise, qofte per llogari te vet ose ne bashkepunim me cdo person fizik apo juridik, qofte shqiptar apo te huaj;
4. aktivitete tregtare ne fushen e energjise dhe industrise.
5. kryerja e cdo aktiviteti tregtar dhe e cdo veprimi ne Shqiperi apo jashte saj, qe ka lidhje te drejtperdrejte apo te terthorte me objektin e mesiperme te Shoqerise ose qe eshte e nevojshme per promovimin e biznesit te Shoqerise dhe per arritjen e objektivave te Shoqerise;
6. realizimin e projekteve koncesionare dhe/ose partneritet publik-privat me institucione te pushtetit qendror dhe autoritetet vendore, ne fusha te ndryshme, per vete apo per persona te trete, perfshire ketu edhe asistencen dhe konsulencen teknike, ligjore, financiare, fiskale kundrejt shoqerive tregtare dhe/ose institucioneve publike ne

- kryerjen e procedurave koncesionare dhe/ose partneriteteve publike private ne çdo sektor apo edhe kundrejt paleve te tjera financiare, tregtare, apo te tjera;
7. ofrimin e sherbimeve te ndermjetesimit te marreveshjeve mes shoqerive tregtare (shqiptare dhe te huaja);
 8. pjesemarrje ne shoqeri, ortakeri apo shoqeri te thjeshta (konsorcium dhe joint venture) nepermjet zoterimit te kuotave/aksioneve, pjeseve te fitimit si dhe kryerja e investimeve ne shoqeri shqiptare dhe te huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqerive dhe asistenca ne veprimtarine e tyre.

NENI 4 KOHEZGJATJA

- 4.1 Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te papercaktuar

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 (nje qind) Leke.
- 5.2 Kapitali i Shoqerise perbehet nga 2 quota, me perfshirje ne kapital sa me poshte:
 1. Ortaku themelues Z. Elvis Pellumbi: Zoterues i 1 (nje) kuote qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
 2. Ortaku themelues Znj. Blerta Avale: Zoteruese e 1 (nje) kuote qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 5.3 Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

NENI 6 ADMINISTRATORI I SHOQERISE

- 6.1 Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si Administratore te Shoqerise, per nje afat te percaktuar me Statut qe nuk i kalon 5 vjet, me te drejte ripertitje.
- 6.2 **Znj. Blerta Avale** , e bija e Llambit, e datelindjes 09.18.1987, shtetase shqiptare, banuese ne Rr. Marko Bocari, Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftim nr. 029148969.
- 6.3 Kompetencat e Administratorit percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

NENI 7 EKSPERTET KONTABEL

- 7.1 Eksperti (et) kontabel i te autorizuar do te emerohet (n) me vendim te Asamblese se Pergjithshme, ne cdo rast kur nje gje e tille kerkohet nga ligji shqiptar.

NENI 8
VITI FINANCIAR

- 8.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- 8.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.


NENI 9
LIKUIDIMI I SHOQERISE


- 9.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :
- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b. Me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c. Me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - d. Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
 - e. Me vendim te gjykates.
- 9.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".
- 9.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- 9.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.
- 9.5 Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Ky Akt Themelimi hartohet ne 3 (tre) kopje dhe nenshkruhet rregullisht nga Ortaket e Shoqerise, sot me date 04.02.2020, ne Tirane.

O R T A K E T
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"EPA SOLAR INVESTMENTS" SHPK


Z. Elvis Pellumbi


Znj. Blerta Avale